



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 1977/3 prot.

Tiranë, më 04.09.2023

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 1977/1, DATË 17.07.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR, TË ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASI Z. GJET PRENGA”

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e Z. Gjet Prenga, me nr. 1472 prot, datë 23.02.2021, ndaj veprimtarisë së magistratëve në Gjykatën e Lartë, Tiranë, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, pa emër konkret të ndonjë magistrati dhe me vendimin nr. 1977/1 prot, datë 17.07.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së parqitur nga shtetasi Gjet Prenga”, bazuar në nenin 120, pika 1, shkronja, “d” dhe “dh”, nenin 121, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqënëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Kurbin, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Lagjja nr.6, Laç-Kurbin;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen në ambientin e bashkisë përkatëse, do të hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko

